



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:126968

Datë: 21.10.2024

Numri i dokumentit: 06325219

KE.nr. 2722/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen juridike të paditësit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Agjencia Pyjore e Kosovës, Drejtoria Koordinues Rajonal me seli në Prizren, kundër të paditurës N.T.Sh. "Iliria" me numër të biznesit 70072679 dhe seli në Vërmicë, Komuna e Prizrenit, me objekt lirimi i pronës dhe kompensimi i dëmit, vlera e objektit të kontestit e pacaktuar, pas shqyrtimit paraprak të lëndës, jashtë seancës, me datën 21.10.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm për të vendosur në çështjen juridike të paditësit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Agjencia Pyjore e Kosovës, Drejtoria Koordinues Rajonal me seli në Prizren, kundër të paditurës N.T.Sh. "Iliria" me seli në Vërmicë, Komuna e Prizrenit, me objekt kontesti lirimi i pronës dhe kompensimi i dëmit.
- II. Për të vendosur lidhur më konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

A r s y e t i m

Paditësi Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Agjencia Pyjore e Kosovës, Drejtoria Koordinues Rajonal me seli në Prizren, me datë 21.06.2021 pranë Gjykatës Themelore

në Prizren ka paraqitur padi për lirim dhe kompensimin e dëmit, ndaj të paditurës N.T.Sh. "Iliria" me seli në Vërmicë, Komuna e Prizrenit.

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, me Aktvendimin C.nr. 1193/2021 të datës 01.11.2022, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike, ndërsa lëndën e transferuar në Gjykatën Komerciale

Tani, gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës, vlerësoi kompetencën lëndore dhe gjeti se Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike pranë Gjykatës Komerciale nuk është kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike, për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 13, pika 1.1 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, me të cilin është përcaktuar se: *"Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre"*. Nisur nga kjo dispozitë, rezulton se Gjykata Komerciale ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë, në kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridik publik dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështjet tjera mes tyre.

Në rastin konkret rezulton se kemi të bëjmë me një kontest nga e drejta sendore, përkatësisht objekt kontesti është lirim i pronës dhe kompensimin e dëmit, kontest ky i cili zhvillohet në mes të personit juridik publik në cilësi të paditësit dhe personit juridik privat në cilësi të të paditurës, dhe rrjedhimisht nuk përbën kontest tregtar dhe as kontest mes shoqërive tregtare lidhur me të drejtat sendore për çka në kuptim të nenit 13, pika 1.7 të Ligjit për Gjykatën Komerciale e kompetencës do të ishte Departamenti i Përgjithshëm i kësaj Gjykate,

Prandaj, në mbështetje të nenin 12 dhe 20 të Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat, lidhur me nenin 41 të Ligjit për Procedurën Kontestimore me të cilin përcaktohet se *"Për gjykim në kontestet lidhur me pronësinë dhe të drejtat sendore të tjera mbi sendet e paluajtshme, në kontestet për shkak të pengim posedimit mbi sendin e paluajtshëm, si dhe në kontestet nga raportet e qiradhënies së paluajtshmërisë, ose nga kontratat për shfrytëzimin e banesave apo të lokaleve të punës, është ekskluzivisht kompetente gjykata në territorin e të cilës ndodhet paluajtshmëria"*,

kjo gjykatë vlerëson se kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është pikërisht Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në Prizren.

Nga sa më sipër, në mbështetje të dispozitave nga neni 17,19, 24 dhe 25.2, lidhur me nenin 387.1, pika u) dhe 392, pika b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 2722/22, datë 21.10.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.